



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 7171/prot.

Tiranë, më 10.11.2025

UDHËZIM

NR. 25, DATË 10.11.2025

PËR

NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 4.3.2020, TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR AFATET E APLIKIMIT, TË ZBATIMIT TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE, PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT, SI DHE NUMRIN E ANËTARËVE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR ANËTARË KOMISIONI PËR DHËNIEN E BURSIVE TË PARASHIKUARA NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKËLQYER DHE NËPUNËSIT CIVILË”

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë” (Fondi i Ekselencës), i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 6, datë 4.3.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”, bëhet shtesa si më poshtë:

a) Pas pikës 1, të Kreut VI, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

“1/1. Përcaktimet e këtij udhëzimi zbatohen vetëm për studentët përfitues të mbështetjes financiare që vijnë studimet në vitet e ndërmjetme dhe kanë përfituar bursë nga Fondi

i Ekselencës sipas përcaktimeve të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nënpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, i ndryshuar””.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Komisioni Përzgjedhës dhe Sekretariati Teknik i Programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

